

FJALA E DEPUTETES GRETA BARDELI

E ENJTE 9 MAJ 2022

Së pari, ju shpreh mirënjohjen nga ky Kuvend, në emër të komunitetit të Shkodrës, të gjithë banorëve të Rinasit, gjithashtu, deputetes sonë të re Andia Ulliri, për qëndresën e tyre që çoi në tërheqjen e qeverisë nga një vendim absurd për bllokimin e lëvizjes së lirë në aksin kryesor drejt aeroportit, ku penalizoheshin drejtpërdrejt edhe qytetarët e qarkut që përfaqësoj. Bllokimi për 5 ditë i rrugës konfirmoi dështimin e turpshëm të qeverisë me investimet e çoroditura dhe klienteliste në infrastrukturën rrugore në vend. Shkodra dhe Veriu janë totalisht të braktisur nga financimet për zgjerimin e rrugëve, në një kohë kur tunelet dhe pistat e helikopterëve i shkojnë në dyert e vilave në bregdet elitës së korruptuar dhe kriminale. E kam shprehur edhe më përpara që prej 20 vjetësh nuk ka asnjë investim për ta zgjeruar rrugën nga Miloti në Shkodër. Ai është kthyer në aksin më të pasigurt, më të frikshëm dhe në një burim të përhershëm aksidentesh që çojnë deri në humbjen e jetës. Meqenëse udhëtoj shpesh, së fundi m'u desh të shihja nga afër, për fat të keq me dhimbje, humbjen e jetës së dy turistëve polakë. Ngushëllime familjeve të tyre! Asnjë hap nuk është bërë nga qeveria për investimet e projektit Thumanë-Kashar.

Rreth 20 kilometra autostradë do të lidheshin me pjesën tjetër, Thumanë-Laç. Financimi ka shkuar në drejtim të paditur, ndërsa rruga aktuale është në një gjendje që të vjen keq. Veriun e keni katandisur në dy rrugica: njërën hyrëse dhe tjetrën dalëse. Ky është turpi i kësaj qeverie. Në fakt, dua të citoj diçka që thonë socialistët e ndershëm në Shkodër: "Nëse doni të kërkoni një investim rrugor, duhet më shpejt t'i biesh telefonit të Zamirit se sa të Ramës". Faleminderit!